



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM  
Nr.140, datë 27.11.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.10, DATË 21.03.2017, “PËR LICENCIMIN E  
SH.A UJËSJELLËS KANALIZIME VLORË”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (**VKM nr. 958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 27.11.2020 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projekt vendimit “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 10, datë 21.03.2017 “Për licencimin e sh.a Ujësjiellës Kanalizime Vlorë”,

**Vëren se:**

1. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Vlorë (**UK Vlorë**) me shkresën nr. 235 prot. ERRU datë 05.11.2020, me lëndë “Dërgim dokumentacioni për ndryshimin e drejtuesit ligjor të sh.a Ujësjiellës Kanalizime Vlorë” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Vlorë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR ka licencuar shoqërinë UK Vlorë me vendimin nr. 10, datë 21.03.2017 “Për licencimin e sh.a Ujësjetllës Kanalizime Vlorë”, me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.
4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Vlorë sh.a. z. Shkëlqim Leskaj, ka mbaruar studimet e larta në Ekonomi dega marketing në vitin 2007.
5. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Vlorë sh.a të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficientën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Vlorë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

#### **VENDOSI:**

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR nr. 10, datë 21.03.2017 “Për licencimin e sh.a Ujësjetllës Kanalizime Vlorë” bëhen këto ndryshime:

*“Drejtues Ligjor Shkëlqim Leskaj”*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Ndriçim Shani**